
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: SEMAKS SH.P.K. me adresë në Prizren Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi , Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	29.05.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **26.05.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **SEMAKS SH.P.K.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET e pa bazuar** kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **SEMAKS SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **29.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik: SEMAKS SH.P.K. me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **29.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **26.05.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Pretendimi nga Operatori Ekonomik Ankimor:

Në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi, pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit dhe kriterëve të përcaktuara për kualifikim, paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim, duke konsideruar se disa nga kriteret e vendosura janë joproporcionale, kufizuese dhe jo plotësisht në përputhje me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, respektivisht parimin e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe garantimit të konkurrencës efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Pas analizimit të kriterëve, konsiderojmë se disa kërkesa tejkalojnë nevojat reale të kontratës dhe kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë pa ndonjë arsytim të mjaftueshëm lidhur me natyrën dhe vlerën e kontratës.

1. Kërkesa lidhur me përvojën profesionale të stafit

Në kuadër të stafit profesional është kërkuar që për disa pozita të caktuara të posedohen minimum 8 vite përvojë pune pas diplomimit, konkretisht për:

Projekt Menaxherin;
Inxhinierin e Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv.

Konsiderojmë se kërkesa për 8 vite përvojë profesionale është e lartë dhe jo proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës.

Për këtë arsye kërkojmë që përvoja minimale e kërkuar të reduktohet nga 8 vite në 5 vite pas diplomimit, pasi që një përvojë e tillë është plotësisht e mjaftueshme për realizimin profesional dhe cilësor të shërbimeve të kërkuara.

Njëkohësisht, në të gjitha pozitat profesionale është kërkuar që stafi të ketë përvojë ekskluzivisht në "projektim", gjë që konsiderojmë se kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën.

Kërkojmë që përvoja të mos kufizohet vetëm në projektim, por të pranohen edhe:

përvoja në ekzekutim të punimeve;
mbikëqyrje;

implementim projektesh;
dhe përvoja të tjera të ngjashme profesionale në fushën përkatëse të inxhinierisë.

Për këtë arsye propozojmë që formulimi:

"me përvojë pune në projektim"

të ndryshohet në:

"me përvojë profesionale në projektim dhe/ose ekzekutim dhe/ose përvoja të ngjashme profesionale në fushën përkatëse".

2. Kërkesat lidhur me softuerët specifikë

Kërkojmë gjithashtu rishqyrtimin e kërkesave lidhur me posedimin e softuerëve:

Plateia ose të ngjashme;
AEC Collection ose të ngjashme.

Konsiderojmë se kërkesa për posedimin e këtyre softuerëve specifikë është jo proporcionale në raport me vlerën dhe natyrën e kontratës.

Softuerët e tillë përfaqësojnë platforma të avancuara dhe me kosto të lartë, të cilat zakonisht kërkohen në projekte infrastrukturore me kompleksitet të lartë teknik, ndërsa shërbimet që janë objekt i kësaj procedure mund të realizohen në mënyrë profesionale edhe me programe të tjera profesionale më të thjeshta dhe ekuivalente.

Përcaktimi i detyrueshëm i softuerëve specifikë krijon kufizim të konkurrencës dhe favorizon operatorë ekonomikë të caktuar.

Për këtë arsye kërkojmë që:

të largohet kërkesa për posedimin e softuerëve specifikë;
ose kriteri të formulohet në mënyrë më të përgjithshme, duke lejuar çdo softuer profesional ekuivalent të përshtatshëm për realizimin e shërbimeve të kërkuara.

3. Kërkesa lidhur me certifikimin nga AAC për operimin e dronit

Gjithashtu kërkojmë rishqyrtimin e pjesës së kriterit ku kërkohet:

“prezantimi i aprovimit valid nga AAC për inxhinierin për operimin e dronit dhe certifikata e lëshuar nga AAC për operim të dronit”.

Konsiderojmë se kjo kërkesë është e panevojshme dhe jo proporcionale në raport me objektin e kontratës.

Operatorët ekonomikë mund të posedojnë pajisjen dhe, sipas nevojës gjatë implementimit të kontratës, të angazhojnë operatorë të licencuar për operimin e dronit.

Kërkesa që certifikimi nga AAC të paraqitet obligativisht në fazën e ofertimit kufizon konkurrencën dhe vendos barriera të panevojshme administrative për operatorët ekonomikë.

Për këtë arsye kërkojmë që të largohet kërkesa për:

aprovimin valid nga AAC;
dhe certifikatën e AAC për operim të dronit në fazën e ofertimit.

4. Kërkesat lidhur me pajisjet gjeodezike dhe teknologjinë e avancuar

Pas analizimit të kërkesave të vendosura, përkatësisht kërkesat 5, 6, 7 dhe 8, konsiderojmë se kriteret në fjalë janë joproportionale me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës, si dhe kufizojnë në mënyrë të panevojshme konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Konkretisht, në dosje janë kërkuar pajisje shumë specifike dhe të avancuara teknologjikisht, duke përfshirë:

DRON profesional me specifika shumë të detajuara teknike;
Pajisje GPS GNSS RTK me parametra të caktuar dhe funksione të avancuara;
Pajisje Total Station Robotic + GPS + Hybrid;
Pajisje SLAM LIDAR 3D Scanner System me karakteristika shumë specifike teknike.

Konsiderojmë se këto kërkesa janë të ekzagjeruara dhe jo të domosdoshme për realizimin e shërbimeve që janë objekt i kësaj kontrate.

Po ashtu, në dosjen e tenderit nuk është arsyetuar në mënyrë konkrete se për cilat pozicione, pjesë të projektit apo aktivitete specifike kërkohen këto pajisje me këto parametra kaq të avancuar teknikë.

Shërbimet e projektimit dhe rilevimit mund të realizohen në mënyrë profesionale dhe konform standardeve teknike edhe me pajisje të tjera gjeodezike profesionale, të cilat përdoren gjerësisht në treg dhe nga operatorë ekonomikë të licencuar, pa qenë e nevojshme të posedohen pajisje me specifika kaq të ngushta dhe të detajuara.

Për më tepër, mënyra e formulimit të kriterëve lë përshtypjen se specififikimet janë përgatitur duke iu përshtatur pajisjeve të operatorëve ekonomikë të caktuar, pasi janë përshkruar karakteristika tepër specifike teknike, të cilat i posedojnë vetëm një numër shumë i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Një qasje e tillë: kufizon konkurrencën; cenon trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë; dhe bie ndesh me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, respektivisht proporcionalitetin, mosdiskriminimin dhe konkurrencën e lirë.

Operatorë të shumtë ekonomikë posedojnë pajisje profesionale gjeodezike dhe teknologji adekuate për realizimin e shërbimeve të kërkuara, mirëpo jo domosdoshmërisht me parametrat identikë të përshkruar në dosje.

Për këtë arsye kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

të rishqyrtojë dhe të largojë specifikimet tepër të detajuara teknike;
kriteret të formulohen në mënyrë më të përgjithshme dhe jo diskriminuese;
të kërkojnë vetëm pajisje profesionale adekuate për realizimin e shërbimeve, pa specifika të panevojshme kufizuese; dhe të hiqen kërkesat të cilat favorizojnë operatorë ekonomikë

të caktuar.

Në fund, duke u bazuar në të gjitha arsyet e cekura më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të bëjë korrigjimin e kriterëve të lartcekura dhe të publikojë Dosje të Korrigjuar të Tenderit, në mënyrë që kriteret të jenë proporcionale, jo diskriminuese dhe në përputhje me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik, duke mundësuar konkurrencë sa më të gjerë dhe trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Përgjigje në Pretendimi Ankimor nga AK:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim lidhur me kriterin të Stafit Profesional të përcaktuara në Dosjen e Tenderit për projekt menaxherin me min. 8 vite përvojë pune në projektim për aktivitetin e prokurimit, Autoriteti Kontraktues e refuzon këtë pretendim si të pabazuar për arsyet në vijim:

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kriteret e kërkuara në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e shërbimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës. Kërkesat për përvojë pune në projektim është vendosur me qëllim të garantimit të cilësisë së shërbimeve, menaxhimit efektiv organizativ, sigurisë, si dhe sigurimit të standardeve profesionale gjatë realizimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha kriteret e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë vendosur në mënyrë proporcionale, jo diskriminuese dhe në funksion të sigurimit të realizimit cilësor dhe të sigurt të kontratës.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ligjore dhe diskrecion profesional që, në përputhje me nevojat e projektit dhe kompleksitetin e shërbimeve, të përcaktojë kriteret minimale të kualifikimit që i konsideron të domosdoshme për realizimin e kontratës.

Prandaj, pretendimi i Operatorit Ekonomik lidhur me ndryshimin “*me përvojë profesionale në projektim dhe/ose ekzekutim dhe/ose përvoja të ngjashme profesionale në fushë përkatëse*”, Refuzohet si i pabazuar.

Pas shqyrtimit të pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me kriteret për pajisjet teknike/gjeodezike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues e refuzon këtë pretendim si të pabazuar për arsyet në vijim:

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kërkesat minimale për pajisjet teknike dhe gjeodezike bazuar në natyrën, kompleksitetin dhe kërkesat profesionale të kontratës për hartimin e projekteve, incizimeve gjeodezike, modelimit 3D, analizave teknike dhe përgatitjes së dokumentacionit teknik.

Kërkesat për pajisje si dron profesional, GPS GNSS RTK, Total Station Robotik, SLAM LiDAR 3D Scanner të specializuara janë vendosur për të garantuar saktësi të lartë në matje, efikasitet operacional, kompatibilitet të të dhënave dhe realizim cilësor të detyrave projektuese dhe gjeodezike që parashihen në kuadër të kontratës.

Specifikimet teknike minimale të kërkuara nuk janë përcaktuar për të favorizuar ndonjë operator ekonomik apo ndonjë prodhues të caktuar, por për të siguruar standard minimal profesional dhe teknik të pajisjeve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë parametrat minimalë teknikë që i konsideron të nevojshëm për përmbushjen e objektivave të projektit.

Sa i përket pretendimeve konkrete:

- Kërkesa për **SLAM LiDAR 3D Scanner** është vendosur për shkak të nevojës për incizim të avancuar 3D, gjenerim të modeleve precize digjitale dhe përpunim efikas të të dhënave hapësinore në terrene dhe objekte komplekse, ku kërkohet saktësi dhe shpejtësi e lartë e incizimit.
- Kërkesa për **dron profesional me kamerë minimum 60 MP** është përcaktuar për të siguruar rezolucion dhe cilësi të lartë të ortofotove, modeleve 3D dhe dokumentimit teknik vizual, të nevojshëm për projektim dhe analiza profesionale.
- Kërkesa për **GPS GNSS RTK me minimum 1408 kanale satelitore** është vendosur me qëllim të sigurimit të saktësisë së lartë në matje, stabilitetit të sinjalit dhe performancës së pajisjes në kushte të ndryshme të terrenit dhe mbulueshmërisë satelitore.
- Kërkesa për **Total Station Robotik + GPS + Hybrid** lidhet drejtpërdrejt me nevojën për integrim të metodave moderne të matjes dhe realizim efikas të punëve gjeodezike dhe projektuese në terren.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha kërkesat janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që kërkohen.

Gjithashtu, Dosja e Tenderit nuk ndalon përdorimin e pajisjeve ekuivalente (të ngjashme) profesionale, përderisa ato përmbushin parametrat minimalë teknikë dhe funksionalë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Prandaj, pretendimi se kriteret janë diskriminuese apo të orientuara drejt operatorëve të caktuar është i pabazuar.

Theksohet se këto kërkesa **nuk janë të lidhura me marka apo prodhues të caktuar**, por janë të bazuara në performancë dhe funksionalitet. Operatorët ekonomikë mund të ofrojnë çdo pajisje ekuivalente (me performancat e specifikuara në dosjen e tenderit) ose më të avancuar që përmbush këto kërkesa minimale.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe sigurimit të konkurrencës së drejtë, duke përcaktuar vetëm ato kërkesa teknike që konsiderohen të domosdoshme për realizimin profesional dhe cilësor të kontratës.

PËRFUNDIM

Pas shqyrtimit të plotë të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha pretendimet e ngritura janë të pabazuara dhe nuk ofrojnë argumente të mjaftueshme juridike apo profesionale për ndryshimin e kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë në përputhje me objektin e kontratës, janë proporcionale, jodiskriminuese dhe të nevojshme për realizimin profesional dhe cilësor të kontratës.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, duke siguruar trajtim të barabartë, konkurrencë të drejtë dhe transparencë në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit.

Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik **refuzohet në tërësi si e pabazuar**, ndërsa kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit mbesin të pandryshuara.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju mundë të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>